

Komuna e Podujevës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Podujevës udhëhiqet nga z.Agim Veliu, i cili vjen nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Z.Veliu, pozitën e njëjtë të Kryetarit të Komunës e ka ushtruar edhe në periudhën 2000-2004. Pas kësaj periudhe z. Veliu ka shërbyer në pozitën e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa nga viti 2007 deri në zgjedhjet lokale të vitit 2009 ka mbajtur pozitën e deputetit të Kuvendit të Kosovës. Në zgjedhjet e fundit, z. Veliu është zgjedhur kryetar komune në raundin e parë me 52% të votave.
2. Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Komuna e Podujevës ka 88.499 banorë.¹ Kjo komunë përbëhet nga 76 fshatra.²
3. Ekzekutivi i Komunës së Podujevës përbëhet prej 11 drejtorive. Ekzekutivi i Komunës së Podujevës nuk ka hyrë në koalicion bashkëqeverisjes me subjektet tjera politike, ngase pjesa dërmuese e asambleistëve janë nga LDK. Kësisoj, nga gjithsej 41 asambleistë sa numëron Kuvendi i Podujevës, 19 prej tyre janë nga LDK, 12 nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), gjashtë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), një nga Partia e Drejtësisë, një nga Partia Social Demokrate, një nga Aleanca Kosova e Re (AKR) dhe një përfaqësues nga Iniciativa Qytetare e Podujevës.³
4. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komunat e vendit i realizuar nga USAID/DEMI, kënaqshmëria e qytetarëve të Podujevës me kryetarin e komunës dhe administratën komunale ka ardhur duke rënë. Gjatë vitit 2011, 80.5% janë deklaruar të kënaqur me punën e Kkyetarit të komunës, përderisa kjo përqindje ka rënë në 74.5% gjatë vitit 2012. Njësoj ka ngjarë edhe me administratën komunale; në vitin 2011, kënaqshmëria me

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2012. Komuna e Podujevës Burimi: http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Komuna e Podujevës. Gjeografia dhe Demografia e Komunës. Faqja Zyrtare. 2013. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/City-guide/Geography.aspx>

³ Komuna e Podujevës. Profili i këshilltareve. Faqja Zyrtare. 2013. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/Municipality/Profiles-of-advisors.aspx>

punën e administratës ka qenë 73.5%, përderisa një vit më vonë kjo përqindje ka rënë në 72.5%.⁴

5. Hulumtimi i UNDP-së i bërë në vitin 2012 tregon se 70% e banorëve të komunës së Podujevës besojnë se autoritetet e tyre lokale kanë kapacitet për të zgjidhur problemet në komunën e tyre, kurse 10% e tyre mendojnë se këto probleme mund të zgjidhen vetëm nga pushteti qendror.⁵
6. Nga ana tjetër në hulumtimin e zhvilluar nga Instituti GAP në vitin 2009, problemet kryesore në Komunën e Podujevës në atë kohë kanë qenë, ndotja e lumit Llap, mungesa e nënkalimeve dhe mbikalimeve në rrugët kryesore, infrastruktura jo e mirë shkollore, përdorimi i armeve të zjarrit nëpër ahengje, prerja e pyjeve si dhe papastërtia në qytet.⁶

Problemët kryesore të Komunës së Podujevës 2013

1. **Mungesa e rrjetit të ujësjellësit dhe ujit të pijes.** Fshatrat të cilat kanë mungesë të rrjetit të ujësjellësit në Podujevë janë Pollata, Përpellaqi, Surdulli, Breca, Hërtica, Orllani, Dumoshi, Pakashtica, Repa, Zakati, Dobërdoli, Popova, Merdarë, ndërsa Dumnica, Letanca kanë rrjet të ujësjellës, por nuk kanë ujë. Orllani përballet me mungesën e ujit të pijes edhe pse ndodhet buzë liqenit të Batllavës, prej të cilit furnizohet edhe një pjesë e Komunës së Prishtinës. Ndërsa fshatrat tjera të cilat kanë problem me ujë të pijshëm dhe ujë në përgjithësi, zgjidhjen e bëjnë me hapjen e puseve individuale. Zonat urbane të qytetit gjatë katër viteve të fundit janë përballur me reduktime të shpeshta dhe të gjata të ujit. Kjo i ka shtyrë banorët që edhe të protestojnë.⁷ Në bazë të hulumtimit nga USAID/DEMI, rreth 21% e qytetarëve të Podujevës kanë deklaruar se uji u ndalet deri në katër orë gjatë ditës, 16% deri në dhjetë orë, afro 10% më shumë se 11 orë gjatë ditës, ndërsa 41% kanë deklaruar se nuk kanë reduktime.⁸

⁴ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 12. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 121. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

⁶ Instituti GAP. Komuna e Podujevës. Raport komunal 2009. Fq 3. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/51813_Podujeva-raporti%20komunal.pdf

⁷ Agjencia e Lajmeve “Kosova Press”. 9 Gusht 2013. Në Podujevë Protestohet për ujë. Burimi: <http://www.kosovapress.com/sq/arkiva/citizens-of-podujeva-protest-for-water-150945/?old=1>

⁸ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 24. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

2. Mbeturinat. Komuna e Podujevës përballet me problemin e mbeturinave të shpërndara në disa zona. Në rrugën “Skënderbeu” në dalje të qytetit është një deponi e egër e mbeturinave. Gjithashtu, deponi të tilla gjenden edhe mbrapa QKMF, si dhe mbrapa parkut të qytetit. Kjo gjendje është pranuar edhe nga udhëheqja e komunës.⁹ Gjithashtu, të liqeni i Batllavës ka mbeturina të shpërndara gjithandej, ndërsa rruga e Lupqit që lidhet me Sellobajë ka deponi me eshtra të kafshëve. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komunat e vendit i realizuar nga Qendra Regjionale për Mjedis (REC), gjendja e tanishme mjedisore në territorin e komunës së Podujevës është e pakënaqshme për gjithsej 40.9% të respondentëve, e kënaqshme për 30.6%, si dhe e mirë për 27.2%.¹⁰

3. Problemet me objektet shkollore. Objekti i shkollës “Shefki Kuleta” në Halabak, është shumë i vjetër dhe nuk i përmbush as kushtet minimale për mësim.¹¹ Gjithashtu, shkolla fillore “Naim Frashëri” në Podujevë dhe ato në fshatin Batllavë dhe Metehi janë shkolla të vjetra dhe që nuk përmbushin kushtet për mbajtjen e mësimin në to. Ndërsa shkollat në Bajqinë dhe Katunishtë nuk kanë hapësirë në mjaftueshme për mbajtjen e mësimin. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komunat e vendit i realizuar nga UNDP, institucioni më i afërt parashkollor mund të arrihet mesatarisht për 17 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës prej 20 minuta), shkolla më e afërt fillore mesatarisht për 14 minuta (njëlloj me mesataren e Kosovës), kurse shkolla më e afërt e mesme arrihet mesatarisht për 24 minuta (në krahasim me mesataren e Kosovës 25 minuta) në këmbë ose me transport publik).¹²

4. Mungesa e ndriçimit publik. Aktualisht vetëm qendra e qytetit është nën sistemin e ndriçimit publik, përkatësisht rruga kryesore “Zahir Pajaziti”, ndërsa rruga “Skënderbeu” që është e gjatë afërsisht 3 km nuk ka fare ndriçim. Lokalitetet tjera në Podujevë dhe rrethinë janë pa sistem të ndriçimit publik, madje ndriçimi mungon edhe në afërsi të objekteve shëndetësore dhe atyre arsimore.

⁹ Komuna e Podujevës. Faqja zyrtare. Takimi i Kryetarit me përgjegjësit e Kompanisë “Pastrimi”. Mars 2013. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/News/Kerkohet-angazhim-ne-ruajtjen-e-ambientit.aspx>

¹⁰ Qendra Regjionale për Mjedis. Raporti i të gjeturave nga hulumtimi mbi Planin lokal të veprimit në Mjedis. Prishtinë, janar 2012. Fq 144.

¹¹ Portali “Kosovaalbaner”. 14 janar 2013. Edhe kësaj i thonë Shkollë. Burimi: <http://kosovaalbaner.com/edhe-kesaj-i-thon-shkollevideo/>

¹² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 122. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

- 5. Ndotja e lumit dhe vërshimet.** Edhe pse është investuar në shtratin e lumit Llap të Podujevës, veçmas në zonën urbane, uji në këtë lum është i ndotur. Në të derdhen ujërat e zeza të fshatrave të cilat nuk e kanë të rregulluar sistemin e kanalizimit, ndarjen e ujërave dhe filtrimin e tyre. Janë të përvitshme vërshimet që prekin fshatrat dhe vendbanimet e kësaj komune nga lumi Llap.¹³ Gjithashtu mungon mirëmbajtja e lumit nga mbeturinat që hidhen nga qytetarët. Në një pjesë të madhe të lumit mungojnë mbrojtëset e sigurisë të cilat në dy raste kanë shkaktuar humbjen e jetës së fëmijëve si pasojë e rënies në shtratin e lumit.
- 6. Mungesa e investimeve në fshatra.** Afro në 20 fshatra të Komunës së Podujevës në tri vjetët e ardhshme nuk është paraparë të investohet në ndonjë projekt. Fshatra që nuk kanë hyrë në listën e prioriteteve të komunës për 2013, 2014 e 2015 janë: Pollatë, fshatrat e brezit kufitar si PërPELLAC, Herticë, Surdull, Potok, Tërrnavicë, Tashefc, Reçicë, Turuçicë, Rakinicë, Metergovc, Bervenik, Muhazob, Brainë, Kalaticë, Bllatë, Zhiti dhe Brecë. Ndërsa pjesa më e madhe e investimeve janë paraparë të bëhen në fshatin Bradash prej nga vie kryetari aktual i komunës, Agim Veliu.¹⁴ Në fshatin Dobratin ku aktualisht jeton Drejtori i Financave i Komunës së Podujevës si dhe fshati Llapashticë nga vije Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në këtë komunë janë paraparë realizimi i katër projekteve të ndryshe për periudhën deri në vitin 2015.¹⁵
- 7. Objektet banesore pa mirëmbajtje dhe pa infrastrukturë.** Ndërtesat publike të cilat e përshkojnë hapësirën përreth sheshit nuk janë të gëlqerosura që nga pas lufta. Në këto ndërtesa vërehet mungesa e dyerve të hyrjes, mungesa e dritareve nëpër shkallët e ndërtesës, mungesa e anësoreve në shkallë, mungesa e ndricimit gjatë natës në korridoret e brendshme të ndërtesave, mungesa e ashensorëve si dhe nuk janë hasur askund të vendosura aparatet për fikjen eventuale të zjarreve. Përveç kësaj, në disa ndërtesa publike hasen të shpërfaqura kablllo të instalimit të brendshëm elektrik të cilat mund të paraqesin rrezik për jetën e banorëve në ato ndërtesa, veçmas për fëmijët.

¹³ Gazeta "Ekxpress" . 22 mars 2013. Pasojat e ndotjes dhe vërshimet në lumin Llap. Burimi: <http://www.gazetaexpress.com/?cid=1,99,106670>

¹⁴ Gazeta "Bota Sot". Kryetari Veliu asfalton rrugën e fshatit të tij. 19.08.2013. Burimi: <http://www.botasot.info/lajme/237472/agim-veliu-asfalton-rrugat-e-fshatit-te-tij/>

¹⁵ Gazeta "Koha Ditore: Nexhat Tovorlani. Njëzet fshatra të Podujevës mbeten jashtë investimeve. Maj 2013. Fq 11.

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur dhe ruajtur

1. **Liçeni i Batllavës.** Liçeni i Batllavës është destinacion i shumë kosovarëve për të pushuar gjatë ditëve të fundjavës. Për shumë vite, zona përreth Liçenit nuk është mirëmbajtur dhe vizitorët kanë lënë shumë mbeturina mbrapa. Këtë vit, Komisioni Evropian, me propozim të Komunës së Podujevës, ka financuar një projekt për ndërtimin e plazhës artificiale dhe çadrave përreth bregut të liçenit. Mirëpo, për shkak se Liçeni njëkohësisht është edhe burim i ujit të pijes për banorët e regjionit të Prishtinës, Instituti i Kosovës për Shëndet Publik ka kërkuar nga Komisioni Evropian që të ndalohen investimet në këtë Liçen. Komuna duhet të jetë mënyra tjera për të investuar në zonat përreth liçenit, pa rrezikuar kualitetin e ujit të pijes.


Trendet Buxhetore në Komunën e Podujevës

Komuna e Podujevës në vitin 2013 ka 16.5 milion euro buxhet, ndërsa krahasuar me vitin 2010 buxheti i kësaj komune ka pasur një rritje prej 2.9 milion euro apo 20%. Pas një rënie të lehtë në vitin 2011, të hyrat vetanake kanë shënuar prapë rritje në vitin 2012. Struktura e të hyrave vetanake dominohet nga tatimi në pronë (26%), taksa komunale për leje ndërtimi (13%) dhe participimet në arsim dhe shëndetësi (12%). Në komunën e Podujevës janë 16.800 prona të regjistruara, ku 5.700 prona (34%) janë pagues të rregullt të tatimit, ndërsa 2.500 (15%) paguajnë pjesërisht. Rreth 50% e tyre nuk paguajnë tatimin.¹⁶ Sipas Raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, sfidë për Komunën mbetet mbledhja e borxheve si dhe numri i vogël dhënieve të lejeve të ndërtimit në krahasim me kërkesën.¹⁷

¹⁶ Komuna e Podujevës, Përgjigje në Kërkesën e Instituti GAP. 16 Gusht 2013

¹⁷ ZAP. Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Podujevës Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 <http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit KPD 2012 Shqip 71340.pdf>


Figura 1. Buxheti i Komunës së Podujevës 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?podujeve/2013#/~/~podujeve>

Grafikoni i mëposhtëm rreth trendeve të ndarjeve buxhetore tregon se me përjashtim të ngritjes së pagave në vitin 2011, kategoritë tjera nuk kanë pasur ndonjë ndryshim të theksuar. Një rënie e lehtë është planifikuar të ndodhë tek shpenzimet kapitale në vitin 2013. Sa i përket shpenzimeve të vitit 2012, Raporti i Auditorit ka identifikuar raste të vonesave në realizimin e kontratave, dhënies së kontratave me vetëm një ofertë valide dhe klasifikim të shpenzimeve me kode të gabuara.

Figura 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2010- 2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2014-2016, buxheti pritet të ketë një rritje prej 856 mijë euro në vitin 2014. Pagat dhe Mëditjet do të vazhdojnë të jenë shpenzimi kryesor ndërsa krahasuar me vitin 2014 shpenzimet kapitale pritet të kenë një ngritje prej 10% në vitin 2016.

Tabela 1. Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve 2014-2016

	2014	2015	2016
Të hyrat totale	16.900.435	17.067.193	17.431.190
Të hyrat vetanake	1.417.500	1.460.025	1.489.226
Grantet	15.482.934	15.607.168	15.941.964
Shpenzimet Totale	16.900.434	17.067.193	17.431.210
Pagat dhe Mëditjet	9.182.370	9.182.370	9.182.370
Mallrat dhe Shërbimet	1.577.785	1.577.785	1.577.785
Subvencionet dhe Transferet	555.000	555.000	555.000
Shpenzimet Kapitale	5.585.279	5.752.038	6.116.055

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Podujevës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.